



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo životne sredine, prostornog planiranja i infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore /Regional River Basin Authority Rajonalni Autoritet
Rijecnog Sliva

RAPORT PËR IDENTIFIKIMIN E SEGMENTEVE
LUMORE PËR PASTRIM

Pellgu Drini i Bardhë

Gusht 2025

Përmbajtja

1.	Hyrje	6
1.1.	Pellgu lumor Drini i Bardhë.....	7
2.	Vlerësimi i Gjendjes në terren	7
2.1.	Komuna e Klinës	7
2.2.	Komuna e Skenderajt	15
2.3.	Komuna Mamushë	20
2.4.	Komuna e Deçanit	23
2.5.	Komuna e Rahovecit	28
2.6.	Komuna e Malishevës.....	37
2.7.	Komuna Istog.....	40
2.8.	Komuna Suharekë.....	44
2.9.	Komuna e Junikut	53
2.10.	Komuna e Pejës	56
2.11.	Komuna e Prizrenit	58
2.12.	Komuna e Dragashit	61
2.13.	Komuna Gjakovë.....	66
3.	Përfundim	67

Lista e figurave:

Figura 1. Segmenti i lumit Drini i Bardhë, Zllakuqani deri te Ranovica.....	8
Figura 2. Segmenti 2, që shtrihet nga liqeni akumulues në Lumin Drini i Bardhë deri te diga.....	9
Figura 3. Segmenti 3, që shtrihet nga Ura e Hekurit deri te Ura e Klinës, shtrati i lumit Drini i Bardhë, ...	10
Figura 4. Segmenti 4, që shtrihet nga Ura e Klinës deri te bazeni në Zajm, ne Lumin Drini I Bardhë.	12
Figura 5. Segmenti 5, në fshatin Qupevë e Ulët, në Lumin Drini i Bardhë.....	13
Figura 6. Segmenti 6, nga Këpuzi deri te bashkimi e Drinit të Bardhë me lumin Mirusha	14
Figura 7. Harta e lumit Klina në Skenderaj.....	17
Figura 8. Lumi i Jasharajve, Skenderaj.	18
Figura 9. Lumi Qubrel, Skenderaj.....	19
Figura 10. Lumi Toplluha dhe Lumi Leshan, Mamushë.....	21
Figura 11. Lumbardhi Lloqanit, Lumbardhi i Deçanit, Lumi Behovci, Përroi i Durakut dhe Përroi i Irzniqit në Deçan.	25
Figura 12. Përroi Kramovik - Çiflak, Përroi Çiflak - Dobidol, Përroi në Dejnë, Përroi i fshatit Ratkoc, Përroi Bratotin - Vrajkë në Komunën e Rahovecit kanë nevojë për pastrim.	32
Figura 13. Përroi Nashpall, Lumi Pataçanit, Rimniku, Përroi Bellacerkë - Bellaja, Përroi Celinë nën Hekurdhë, Përroi Krushë e Madhe dhe Celinë, Përroi Retijë, Zaqishtë, Opterushë në Komunën e Rahovecit kanë nevojë për pastrim.	33
Figura 14. Lumi Mirusha që kalon nëpër fshatrat Ngucat, Temeqin, Banjë, Turjakë dhe Bubël.	39
Figura 15. Drini i Bardhë, Lumi Gujaç, Lumi Shushica, Lumi Qaushi, Lumi Vrella, Ujëmbledhësi Bollovani dhe Ujëmbledhësi Lubozhda në Komunën e Istogut.	42
Figura 16. Lumi Toplluha, Lumi Semetishtes, Lumi Leshan, Sopi, Lumi i Zi, Lumi Bllacë, Lumi Mirusha dhe Lumi Bukosh të Komunës së Suharekës.....	48
Figura 17. Segmenti Arasha - Batushë, Erenik, Segmenti Llugat e Begit, Segmenti Junik - Rastavicë, Segmenti prapa ish fabrikës së tekstilit, Segmenti Makaj - Jasiq, Erenik, dhe Segmenti në Gjocaj	54
Figura 18. Lumbardhi i Pejës	56
Figura 19. Drini I Bardhë, Lumbardhi i Prizrenit dhe Lumi Toplluha segmentet për pastrim të propozuara nga Komuna e Prizrenit.....	59
Figura 20. Harta e Lumenjve që kanë nevojë për pastrim në Dragash.....	62
Figura 21. Harta e segmenteve për pastrim Gjakovë	67

Lista e fotove:

Foto 1. Drini i Bardhë është i ndotur nga bimësia barishtore në zonën e marrjes së ujit nga fabrika e përpunimit të ujit të pijshëm që menaxhohet nga KRU “Hidrodrini”.....	9
Foto 2. Pamje nga Drini i Bardhë - diga e vogël e ndërtuar për qëllime akumulimi të ujit të pijshëm.	10
Foto 3. Argjinatura e shkurtër në të dy anët e urës së Hekurit, përgjatë lumit Drini i Bardhë.	11
Foto 4. Bypasi te ura Drini i Bardhë, për mbrojtjen e zonës nga përmbytjet.	11
Foto 5. Zona tek Ura e Hekurit e vërsuar në vitin 2023.	12
Foto 6. Pamje e shtratit të Drinit të Bardhë tek Ura e Klinës.	13
Foto 7. Pamje e Drinit të Bardhë tek Guri i Zi.	14
Foto 8. Vërshimi në Skenderaj, nga Lumi Klina 21.01.2023.	17
Foto 9. Lumi Klina është i mbushur me vegjetacion dhe mbeturina.	17
Foto 10. Dëmtimi i shtratit të Lumit Klina nga vërshimet e fundit të vitit 2023.	18
Foto 11. Shtrati i Lumit Qubrel i ndotur nga mbeturina.	20
Foto 12. Gjendja e shtratit te lumit Toplluha, Mamushë.	21
Foto 13. Gjendja e Lumit Leshan, Mamushë.	22
Foto 14. Foto nga përmbytjet të shkaktuara nga Lumi Toplluha dhe Lumi i Leshanit në Mamushë.	22
Foto 15. Lumbardhi i Deçanit.	25
Foto 16. Lumbardhi i Lloqanit.	26
Foto 17. Lumi i Behovcit.	26
Foto 18. Përroi i Durakut.	27
Foto 19. Vërshimet në Deçan.	27
Foto 20. Përroi i fshatit Bellacërkë – Bellaja.	34
Foto 21. Përroi në fshatin Celinë - nën Hekurudhë.	34
Foto 22. Përroi në mes të fshatrave Krushë e Madhe dhe Celinë - nën rrugën magjistrale.	35
Foto 23. Përroi në fshatin Çifllak – Dobidol.	35
Foto 24. Përroi në mes fshatrave Kramovik – Çifllak.	36
Foto 25. Përroi në mes fshatrave Bratotin dhe Vrajakë.	36
Foto 26. Foto nga vërshimet në Komunën e Rahovecit.	37
Foto 27. Lumi Mirusha.	40
Foto 28. Lumi Çausi.	43
Foto 29. Lumi Gujavci.	43
Foto 30. Lumi Istog (Burim).	44
Foto 31. Vërshimet nga Lumi Toplluha, Suharekë.	49
Foto 32. Vërshimet nga Lumi Leshan, Suharekë.	49
Foto 33. Vërshimet nga Lumi Semetisht-Toplluha, Suharekë.	49
Foto 34. Vërshimet nga Lumi i Semetishtit, i cili rrjedh në jugperëndim të zonës së banimit në fshatin Semetisht, Suharekë.	50
Foto 35. Vërshimet nga Lumi Bukosh, Suharekë.	50
Foto 36. Vërshimet nga Lumi Mirusha, Suharekë.	51
Foto 37. Vërshimet nga Segment i lumit Leshan në jugperëndim të fshatit Savrovë, Suharekë.	51
Foto 38. Vërshimet nga Lumi Sopijsa, në fshatin Sopijsë, Suharekë.	52

Foto 39. Vërshimet nga Lumi I Zi, Mushtisht, Suharekë	52
Foto 40. Segmenti Arasha - Batushë, Lumi Erenik, Junik	54
Foto 41. Llugat e Begit, Junik	55
Foto 42. Segmenti Gjocaj, Junik	55
Foto 43. Lumbardhi i Pejës.....	57
Foto 44. Lumbardhi i Prizrenit	60
Foto 45. Drini i Bardhë, Prizren	60
Foto 46. Zaplluzhë.....	63
Foto 47. Bresanë	63
Foto 48. Blaq	64
Foto 49. Kosave	64
Foto 50. Kuk	65
Foto 51. Kapre	65
Foto 52. Lumi Erenik	67

Lista e tabelave:

Tabela 1. Segmentet lumore për pastrim - Klinë	7
Tabela 2. Segmentet lumore për pastrim - Skenderaj	15
Tabela 3. Segmentet lumore për pastrim - Mamushë.....	20
Tabela 4. Segmentet lumore për pastrim - Deçan	23
Tabela 5. Segmentet lumore për pastrim - Rahovec	28
Tabela 6. Segmentet lumore për pastrim - Malishevë	38
Tabela 7. Segmentet lumore për pastrim – Istog	41
Tabela 8. Segmentet lumore për pastrim – Suharekë	44
Tabela 9. Segmentet lumore për pastrim – Junik	53
Tabela 10. Segmentet lumore për pastrim – Pejë	56
Tabela 11. Segmentet lumore për pastrim – Prizren.....	58
Tabela 12. Segmentet lumore për pastrim – Dragash	61
Tabela 13. Segmentet lumore për pastrim - Gjakovë.....	66
Tabela 14. Segmentet lumore të nevojshme për pastrim - Pellgu Lumor Drini i Bardhë	69
Tabela 15. Pasqyrë e km totale dhe me prioritet për pastrim.....	75

1. Hyrje

Pellgu Lumor i Drinit të Bardhë është pellgu më i madh ujqor në territorin e Republikës së Kosovës, i cili mbulon një sipërfaqe të gjerë dhe përfshin gjithsej 13 komuna. Ky pellg përbën një burim të rëndësishëm të ujit për përdorim shtëpiak, bujqësor, industrial dhe për ruajtjen e biodiversitetit natyror.

Qëllimi kryesor i këtij raporti është të adresojë nevojën për identifikimin dhe ndërhyrjen në segmentet e lumenjve që paraqesin ndotje apo rrezik mjedisor në kuadër të Pellgut Lumor të Drinit të Bardhë. Në këtë drejtim, raporti synon të ofrojë një pasqyrë të qartë mbi gjendjen aktuale të lumenjve, duke përfshirë mbledhjen sistematike të të dhënave nga komunat përkatëse përmes një forme të unifikuar.

Ky raport ka një sërë objektivash specifike që ndihmojnë në realizimin e një vlerësimi të saktë dhe të qëndrueshëm të nevojave për pastrim në segmentet lumore të Drinit të Bardhë. Një ndër objektivat kryesore është hartimi i një liste të detajuar dhe të besueshme të segmenteve kritike që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme, bazuar në të dhënat e mbledhura nga terreni.

Gjithashtu, një komponent kyç i këtij procesi është bashkëpunimi dhe koordinimi i ngushtë me zyrtarët komunalë në secilën nga komunat përkatëse, për të siguruar që informacioni i mbledhur të jetë i saktë dhe gjithëpërfshirës. Në këtë kuadër, sigurohet edhe mbledhja e koordinatave të sakta gjeografike për secilin segment të identifikuar, gjë që ndihmon në përgatitjen e hartave dhe në planifikimin efikas të ndërhyrjeve.

Përmes këtij procesi synohet të vlerësohet ndikimi i ndotjes në mjedis, dëmet nga përmytjet për komunitetet përreth, si dhe përcaktimi i prioriteteve për ndërhyrje në terren. Po ashtu, raporti synon të shërbejë si bazë për hartimin e rekomandimeve konkrete që lidhen me pastrimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të lumenjve, duke kontribuar kështu në përmirësimin e gjendjes mjedisore në nivel lokal dhe rajonal.

Së fundmi, raporti synon të realizojë një proces të qartë prioritizimi të segmenteve, bazuar në shkallën e ndotjes, rrezikun për komunitetin dhe urgjencën e nevojës për ndërhyrje, me qëllim që resurset të shfrytëzohen në mënyrën më efektive të mundshme.

1.1. Pellgu lumor Drini i Bardhë.

Pellgu i lumit Drini i Bardhë ka sipërfaqe të përgjithshme 4,567 km². Drini i Bardhë buron në Kosovë, në veri të qytetit të Pejës, dhe më pas rrjedh në lindje dhe juglindje drejt kufirit me Shqipërinë. Gjatësia totale e tij është 122 km. Brenda territorit të Kosovës, lumi Drini i Bardhë merr shumë degë relativisht të gjata. Lumenjtë kryesorë të pellgut të Drinit të Bardhë janë: Drini i Bardhë, Lumbardhi i Pejës, Lumbardhi i Deçanit, Ereniku, Istogu, Shushica, Klina, Mirusha, Toplluha, Lumbardhi i Prizrenit, Plava dhe Restelica.

Pellgu lumor i Drinit të Bardhë përfshinë 13 komuna: Pejë, Deçan, Gjakovë, Dragash, Istog, Klinë, Rahovec, Prizren, Skenderaj, Suharekë, Malishevë, Junik dhe Mamushë.

2. Vlerësimi i Gjendjes në terren

Ky kapitull paraqet një vlerësim fillestar të gjendjes së segmenteve lumore në kuadër të komunave që përfshihen në Pellgun Lumor të Drinit të Bardhë. Të dhënat janë mbledhur në bashkëpunim me zyrtarët komunalë përkatës, përmes inspektimeve në terren dhe formateve të standardizuara të raportimit. Vlerësimi përqendrohet në identifikimin e segmenteve me nivel të lartë ndotjeje ose me bllokime fizike të rrjedhës së lumenjve, duke marrë parasysh shtrirjen gjeografike, ndikimin në mjedis, rrezikun për komunitetin dhe urgjencën për ndërhyrje. Komunitat e mëposhtme përfaqësojnë zonat kryesore ku është evidentuar nevoja për pastrim dhe ndërhyrje mjedisore.

2.1. Komuna e Klinës

Nëpër territorin e Komunës së Klinës rrjedhin gjashtë lumenj kryesorë: Drini i Bardhë, Lumbardhi i Pejës, Klina, Mirusha, Lumi i Istogut dhe Lumbardhi i Deçanit.

Komuna e Klinës përballet me përmytje si pasojë e hedhjes së mbeturinave, depozitimit të sedimenteve në shtretërit e lumenjve dhe zhvillimit të dendur të vegetacionit në disa segmente, veçanërisht në zonat përreth Drinit të Bardhë. Komuna ka propozuar gjithsej gjashtë segmente lumore që kërkojnë pastrim, duke përfshirë lumenj me ndikim të drejtpërdrejtë në zonat urbane dhe bujqësore. Përmytjet e fundit, gjatë vitit 2023, kanë prekur vendbanime si: Shtjërç, Gjurgjevik i Madh, Zajm, Poterq, Jashanicë, Zllakuqan, Krushë e Madhe, Siçevë, Zajm, Klinë, Volljak, Dollovë dhe Grabanicë.

Tabela 1. Segmentet lumore për pastrim - Klinë

Nr.	Segmenti i lumit	Koordinata e fillimit të segmentit	Koordinata e mbarimit të segmentit	Gjatësia	Arsyeja, banorët/zona të prekura
1	Zllakuqan deri te Ranovica	Y=7461924.300 X=4724878.200	Y=7462344.300 X=4724289.000	750m	Prania e shkurreve, inerteve si dhe zhavorit që ka mbuluar shtratin e lumit pengon rrjedhën e ujit, duke shkaktuar përmytje gjatë reshjeve të mëdha. Ky segment përfshin fshatrat Zllakuqan dhe Gjyrakovc.

2	Liçeni akumulues në lumin Drini i Bardhë deri te diga.	Y=7464238.550 X=4721402.100	Y=7464425.650 X=4720386.000	1.2km	Prani e bimësisë ujore që mund të tregojë ndotje/eutrofikim; ndikon potencialisht në cilësinë e ujit të pijshëm.
3	Ura e Hekurit deri Ura Klinës	Y=7464778.350 X=4717925.000	Y=7465101.450 X=4717127.600	1.5km	Prania e bimësisë ujore tregon ndotje apo eutrofikim, duke ndikuar potencialisht në cilësinë e ujit të pijshëm.
4	Ura Klinës deri të bazeni Zajm	Y=7465139.250 X=4717091.900	Y=7464776.650 X=4716509.500	1.27km	Prania e shkurreve, inerteve si dhe zhavorit që ka mbuluar shtratin. Ky lloj pengimi bën të pamundur rrjedhjen e ujit, gjë e cila po shkakton përmytje gjatë reshjeve të mëdha mbi këtë segment.
5.	Qupevë e ultë	Y=7464328.030 X=4714858.250	Y=7464542.350 X=4713642.050	820M	Prania e shkurreve, inerteve si dhe zhavorit që ka mbuluar shtratin.
6.	Nga parcela 00045-2 ZK-Këpuz deri te Pika e bashkimit të Drinit të Bardhë me lumin Mirusha (tek Guri i Zi)	Y=7463935.940 X=4712591.340	Y=7463821.590 X=4709443.240	4km	Prania e shkurreve, inerteve si dhe zhavorit që ka mbuluar shtratin.

*(Burimi: të dhëna të siguruara nga Komuna)



Figura 1. Segmenti i lumit Drini i Bardhë, Zllakuqani deri te Ranovica

Segmenti 2, që shtrihet nga zona e marrjes së ujit për fabrikën e ujit të pijshëm në Lumin Drini i Bardhë deri te diga, ka një gjatësi prej rreth 1.2 kilometrash. Kjo zonë paraqet nevojë me prioritet për pastrim, pasi nga këtu merret uji që shkon në fabrikën e përpunimit të ujit të pijshëm ku furnizohet Klina me ujë. Prandaj, pastrimi i këtij segmenti është i domosdoshëm për të mbrojtur cilësinë e ujit.



Figura 2. Segmenti 2, që shtrihet nga liqeni akumulues në Lumin Drini i Bardhë deri te diga.



Foto 1. Drini i Bardhë është i ndotur nga bimësia barishtore në zonën e marrjes së ujit nga fabrika e përpunimit të ujit të pijshëm që menaxhohet nga KRU "Hidrodrini".



Foto 2. Pamje nga Drini i Bardhë - diga e vogël e ndërtuar për qëllime akumulimi të ujit të pijshëm.

Segmenti 3, që shtrihet nga Ura e Hekurit deri te Ura e Klinës, shtrati i lumit Drini i Bardhë, në një gjatësi prej rreth 1.5 kilometrash paraqet prani të shkurreve, materialeve inerte dhe zhavorrit që ka mbuluar shtratin e lumit.




Figura 3. Segmenti 3, që shtrihet nga Ura e Hekurit deri te Ura e Klinës, shtrati i lumit Drini i Bardhë,

Kjo zonë ka qenë plotësisht e përmbytur gjatë vitit 2023. Si masë emergjente, Komuna ka ndërtuar një bypass përgjatë lumit, i cili ndihmon në mbrojtjen e një pjese të zonës nga përmbytjet. Po ashtu, janë

ndërtuar argjinatura në të dy anët e urës së Hekurit, por vetëm në një distancë shumë të shkurtër, si masë parandaluese ndaj përmbytjeve.

Megjithatë, shtrati i lumit në këtë segment ka ende nevojë për ndërtimin e argjinaturave më të gjata dhe të qëndrueshme, si dhe për largimin e sedimentit të akumuluar, i cili përkeqëson rrezikun nga përmbytjet dhe ul kapacitetin e rrjedhjes së ujit.



Foto 3. Argjinatura e shkurtër në të dy anët e urës së Hekurit, përgjatë lumit Drini i Bardhë.



Foto 4. Bypasi te ura Drini i Bardhë, për mbrojtjen e zonës nga përmbytjet.



Foto 5. Zona tek Ura e Hekurit e vërshuar në vitin 2023.

Segmenti 4, që shtrihet nga Ura e Klinës deri te bazeni në Zajm, në një gjatësi prej rreth 1.27 kilometrash ka nevojë për largimin e sedimentit të akumuluar, si dhe për ndërtimin e argjinaturave më të gjata dhe më të qëndrueshme, i cili e ulë ndjeshëm rrezikun nga përmbytjet. Problemi kryesor në këtë zonë është devijimi i shtratit të lumit, pra dalja e tij nga kufijtë natyrorë, gjë që ka shkaktuar ndikime negative në mjedis dhe në infrastrukturë.



Figura 4. Segmenti 4, që shtrihet nga Ura e Klinës deri te bazeni në Zajm, në Lumin Drini i Bardhë.



Foto 6. Pamje e shtrazit të Drinit të Bardhë tek Ura e Klinës.

Segmenti 5, në fshatin Qupevë e Ulët, në Lumin Drini i Bardhë. Në një gjatësi prej rreth 820 metrash paraqet prani të shkurreve, materialeve inerte dhe zhavorrit që ka mbuluar shtratin e lumit.



Figura 5. Segmenti 5, në fshatin Qupevë e Ulët, në Lumin Drini i Bardhë.

Segmenti 6, që shtrihet nga parcela 00045-2, zona kadastrale Këpuz në Lumin Drini i Bardhë deri te pika e bashkimit të Drinit të Bardhë me lumin Mirusha (Guri i Zi), në një gjatësi prej rreth 4 kilometrash paraqet prani të konsiderueshme të shkurreve, materialeve inerte dhe zhavorrit që ka mbuluar shtratin e lumit.




Figura 6. Segmenti 6, nga Këpuzi deri te bashkimi e Drinit të Bardhë me lumin Mirusha



Foto 7. Pamje e Drinit të Bardhë tek Guri i Zi.

2.2. Komuna e Skenderajt

Territori i Skenderajt karakterizohet nga një rrjet i dendur hidrografik me lumenj, përrenj dhe burime të shumta, të cilët burojnë dhe kalojnë në zonën kodrinoro-malore të komunës. Lumenjtë kryesorë janë: Lumi Klina, Lumi i Jasharajve, Lumi i Projit të Keq, Lumi i Qubrelit, Lumi i Runikut, Përroi i Rezallës, Përroi i Rakinicës, Përroi i Prekazit Epërm dhe Ternafcit

Problemet kryesore:

- Ndotja e rrjedhave lumore nga mbeturinat dhe bimët barishtore.
- Përmbytjet e shpeshta.
- Rritjen e kapacitetit të impiantit të trajtimit të ujërave të zeza në Llaushë.

Lumi kryesor që përshkon këtë qytet është lumi Klina. Ky lum derdhet në lumin Drini i Bardhë. Në disa segmente, shtrati i këtij lumi është i rregulluar, por si pasojë e vërshimeve të vitit 2023 është dëmtuar dukshëm. Prandaj, përveç pastrimit, ky lum ka nevojë edhe për rirregullim të shtratit.

Tabela 2. Segmentet lumore për pastrim - Skenderaj

Nr.	Segmenti i lumit	Koordinata e fillimit të segmentit	Koordinata e mbarimit të segmentit	Gjatësia e nevojsh me për pastrim	Arsyeja, banorët/zona të prekura
1	Segmenti i Lumit Klina prej ures ne Rr. Osman Geci-Ali Gashi-H.dhe Kaqkini” ne Skenderaj	Y=7483191.88 X=4733206.92	Y=7483005.39 X=4732841.74	1,380 m	Prania e shkurreve, inerteve, si dhe zhavorit dhe gurëve që kanë mbuluar shtratin. Ky lloj pengimi e bën të pamundur rrjedhën e ujit, gjë që po shkakton përmbytje gjatë reshjeve të mëdha. Në këtë segment jetojnë qindra familje dhe ka shumë tokë të punueshme.
2	Segmenti i lumit Klina prej ures ne RR,Ilaz Kodra-O.Geci” ne Skenderaj	Y=7483205.44 X=4733220.02	Y=7482929.78 X=4734210.57	570 m	Prania e bimësisë ujore mund të tregojë ndotje, e cila ndikon potencialisht në pamjen dhe në aromën tepër të keqe të ujit, ndërsa rrjedhja është e penguar, duke rritur

					rrezikun për vërshime.
3	Segmenti i lumit Jasharajve ne Rr" H.B. Lushtaku "" deri te ura ne rr" Azem Bejta"" ne Skenderaj	Y=7483888.47 Y=7483412.33	X=4734319.20 X=4733571.23	800 m	Faza e I-rë: Pastrimi Faza e II-të: Rregullimi i shtratis (vazhdim i projektit nga punët e ndërprera më herët nga MMPHI) Në këtë zonë vërshohen shumë ekonomi familjare dhe gjithmonë shkatohen dëme të konsiderueshme nga përmbytjet.
4	Lumi i Qubrelit-Llaushë	Y=7483323.83 Y=7481583.45	X=4737511.18 X=4731946.30	8.5 km	Lumi i Qubrelit, në segmentin që kalon nëpër fshatin Llaushë dhe derdhet në lumin Klina, në të gjitha vitet paraprake ka dalë nga shtrati, ka vërshuar dhe ka shkaktuar dëme në ekonomi familjare, bujqësi dhe infrastrukturë tjetër. Pastrimi dhe zgjerimi i këtij lumi parandalon në masë të madhe këto përmbytje.
	Prroji i Polacit dhe Kryshecit	Nuk ka dërguar, koordinatë	Nuk ka dërguar, koordinatë	4km	Takohen në Lagjen 6 në Skenderaj dhe derdhen në lumin Klina. Kanë prurje sezonale dhe shkatojnë vërshime gjatë reshjeve të shiut, sidomos kur ato zgjasin më shumë.
	Prroji i Klodernices	Nuk ka dërguar, koordinatë	Nuk ka dërguar, koordinatë	Nuk ka dërguar, gjatësi	Prroji i Klodernicës ka derdhjen në lumin e Runikut. Gjatë kohës së reshjeve, prurjet janë të mëdha.

*(Burimi: të dhëna të siguruara nga Komuna)




Figura 7. Harta e lumit Klina në Skenderaj



Foto 8. Vërshimi në Skenderaj, nga Lumi Klina 21.01.2023.



Foto 9. Lumi Klina është i mbushur me vegjetacion dhe mbeturina.



Foto 10. Dëmtimi i shtratit të Lumit Klina nga vërshimet e fundit të vitit 2023.



Figura 8. Lumi i Jasharajve, Skenderaj.



Foto 11. Gjendja e shtratit të Lumit të Jasharajve.




Figura 9. Lumi Qubrel, Skenderaj.



Foto 11. Shtrati i Lumit Qubrel i ndotur nga mbeturina

2.3. Komuna Mamushë

Komuna e Mamushës, si komuna më e vogël në pellgun e Drinit të Bardhë, ka dy lumenj kryesorë Toplluhën dhe Leshanin. Të dy këta lumenj janë të prirë ndaj vërshimeve, duke ndikuar jo vetëm tek ekonomitë familjare, por veçanërisht tek tokat bujqësore. Komuna, herë pas here, ka kryer pastrimin e lumit Toplluha në zonën e qytetit, por ka ende nevojë për pastrim të plotë të shtratit.

Tabela 3. Segmentet lumore për pastrim - Mamushë

Nr .	Segmenti i lumit	Koordinata e fillimit të segmentit	Koordinata e mbarimit të segmentit	Gjatësia e nevojshme për pastrim	Arsyeja, banorët/zona të prekura
1	Lumi Toplluha	42.33651, 20.73417	42.30839, 20.72016	4 km	Mbeturinat dhe vegjetacioni, shkaktojnë vërshime, dëmtojnë ekonomitë familjare dhe tokat bujqësore.
2	Lumi Leshan	42.33178, 20.75974	42.32076, 20.72767	3.45 km	Mbeturinat dhe vegjetacioni, shkaktojnë vërshime, dëmtojnë ekonomitë familjare dhe tokat bujqësore.




Figura 10. Lumi Toplluha dhe Lumi Leshan, Mamushë.



Foto 12. Gjendja e shtratit te lumit Toplluha, Mamushë.



Foto 13. Gjendja e Lumit Leshan, Mamushë



Foto 14. Foto nga përmbytjet të shkaktuara nga Lumi Toplluha dhe Lumi i Leshanit në Mamushë.

2.4. Komuna e Deçanit

Komuna e Deçanit, ndodhet në perëndim të Kosovës në Rrafshin e Dukagjinit rrëzë Bjeshkëve të Nemuna. Lumenjte kryesor të komunes së Deçanit janë: Lumbardhi i Deçanit, Lumbardhi i Lloqanit, Lumi i Hulajve, Lumi i Behovcit, Përroi i Durakut, etj.

Ndër sfidat kryesore që përballon kjo komunë në drejtim të gjendjes dhe menaxhimit të ujërave janë:

- Sfidat me mbeturinat dhe vegjetacionin në shtratin e lumenjve;
- Nevojë urgjente për ndërtimin e një impianti për trajtimin e ujërave të zeza;
- Rrezik nga përmytjet në disa lumenj dhe përrenj.

Komuna ka propozuar pesë segmente për pastrim, të gjitha të konsideruara me prioritet të lartë, pasi secili prej tyre paraqet rrezik për vërshime. Fushat në lindje të Prilepit, Rastavicës, fusha Devoll e fshatit Baballoq, lagjet Regjaj dhe Mushkolaj në fshatin Gramaqel vërshohen nga lumi i Lloqanit. Zonat nga Ura e Demës, duke përfshi fushat në veri të Deçanit, Llukë e Epërme dhe Ultë, Lumbardh, Kotradiq dhe Vranoci Vogël rrezikohen nga Lumëbardhi i Deçanit. Sipërfaqet nga lagja Hajrizaj deri te Zalli Strellcit, Isnij (Lagja Bruqëve) dhe Dubovik vërshohen nga Përroi i Behovcit. Pjesa veriore e fshatit Strellc i Epërm dhe aksi i magjistrales Strellc i Epërm - Lybeniq vërshohen nga Përroi i Durakut.

Tabela 4. Segmentet lumore për pastrim - Deçan

Nr.	Segmenti i lumit	Koordinata e fillimit të segmentit	Koordinata e mbarimit të segmentit	Gjatësia e nevojshme për pastrim	Arsyeja, banorët/zona të prekura
1	Lumi i Lumbardhit Segmenti nga Rr "Halil Qela" në fshatin Llukë deri te ura në fshatin Broliq.	Y=7443517.01 X=4712392.12	Y=7447253.79 X=4712715.30	2.1 km	Për shkak të aluvioneve nga mospastrimi dhe zhvillimi i vegjetacionit dhe mbeturinave në rrjedhën e lumit, ky lumë ka dalë nga rrjedha e vet, duke përmytur tokat bujqësore që gjenden afër lumit.
2	Lumi i Lloqanit Segmenti nga fshati Hulaj deri në fund të fshatit Rastavicë.	Y=7439470.06 X=4711040.30	Y=7445527.87 X=4705655.24	7.9 km	Konsiderohet njëra nga pikat më të rrezikshme për sa i përket rrezikut nga vërshimet, kjo për shkak të pemëve të mëdha, mbeturinave të shumta dhe shkurreve.
3	Lumi i Behovcit	Y=7441480.39	Y=7446241.90	5.43 km	Pemët, shkurret

	Segmenti prej rr." Sadri Xhemë Hajrizaj" në Strellc të Epërm deri te rr." Kadri Zeka" në fshatin Dubovik.	X=4715522.74	X=4714862.28		dhe mbeturinat e shumta inerte, të hedhura nga qytetarë të papërgjegjshëm, kanë bërë të pamundur rrjedhjen normale të ujit, gjë që po shkakton përmbytje gjatë reshjeve të mëdha përgjatë këtij segmenti. jetojnë qindra familje dhe ka shumë tokë bujqësore.
4	Përroi i Durakut Gjendet në fshatin Strellc i Epërm Fillon nga lagjja Kapitaj dhe përshkon rrugën regjionale Deçan -Pejë.	Y=7441726.38 X=4716051.57	Y=7442151.04 X=4716168.74	1.85 km	Me rastin e reshjeve atmosferike, vjen deri te bllokimi i kanalit dhe urës si pasojë e prurjeve të ujit, si dhe të mbeturinave të shumta që grumbullohen. Gjithashtu, ky bllokim shkakton vërshime edhe në rrugën kryesore Deçan-Pejë.
5	Përroi i Irzniqit	42.52418, 20.36934	42.5261, 20.36481	520m	Për shkak të bllokimeve dhe mosmirëmbajtjes së kësaj rrjedhe, uji gjatë reshjeve të shiut del nga shtrati i vet dhe përmbyt tokat bujqësore.

*(Burimi: të dhëna të siguruara nga Komuna)




Figura 11. Lumbardhi Lloqanit, Lumbardhi i Deçanit, Lumi Behovci, Përroi i Durakut dhe Përroi i Irzniqit në Deçan.



Foto 15. Lumbardhi i Deçanit



Foto 16. Lumbardhi i Lloqanit




Foto 17. Lumi i Behovcit



Foto 18. Përroi i Durakut



Foto 19. Vërshimet në Deçan

2.5. Komuna e Rahovecit

Lumi më i madh që kalon në territorin e komunës së Rahovecit është Drini i Bardhë. Edhe pse nuk buron brenda komunës së Rahovecit, ai është ujëmbledhësi kryesor i të gjitha degëve dhe lumenjve të komunës. Nëpër territorin e Rahovecit, ky lumë ka një gjatësi prej 30 km. Lumenjtë që derdhen në Drinin e Bardhë në këtë zonë janë: lumi Drinas, Rimniku, Polluzha dhe Hoça. Rrjedhat e ujërave më të ndotura kalojnë nëpër territorin e qytetit të Rahovecit dhe vendbanimeve përreth, janë Rimniku, Duhlllo, Sapnia dhe Bellaja, si pasojë e hedhjes së mbeturinave dhe shkarkimit të ujërave të zeza.

Zonat që mund të goditen më së shumti nga vërshimet janë: Fshatrat Bellacërkë (Fortesë), Sapniq, Krushë e Madhe, Celine, Cifilak, Dejne, Xerxë, Gexhe, Radostë, Ratkoc dhe pjesa jugore e qytetit të Rahovecit (nën qyteti). Drini i Bardhë që kalon neper pjesen e Rahovecit ka nevojë për pastrim i gjithë shtrati, së bashku me 10 perrenjtë kryesor që derdhen në të, të cilët janë të cekur në formën tabelare.

Tabela 5. Segmentet lumore për pastrim - Rahovec

Nr.	Segmenti i lumit	Koordinata e fillimit të segmentit	Koordinata e mbarimit të segmentit	Gjatësia e nevojshme për pastrim	Arsyeja, banorët/zona të prekura
1	Përroi i fshatit Bellacërkë - Bellaja	42.325719, 20.589208	42.354970, 20.592021	3 km	Shtrati i lumit është i mbuluar me shkurre, inerte ndërtimi dhe zhavorr, të cilat pengojnë rrjedhën natyrale të ujit dhe po shkaktajnë përmbytje gjatë reshjeve të mëdha. Nevojitet pastrim i menjëhershëm për të shmangur dëmet e mëtejshme.
2	Përroi i fshatit Ratkoc - në mes të fshatit	42.409232, 20.518863	42.412442, 20.539089	2 km	Prania e bimësisë ujore që tregon ndotje ose eutrofikim; ndikon potencialisht në cilësinë e ujit të pijshëm.
3	Përroi në fshatin Celinë - nën Hekurudhë	42.316630, 20.601927	42.328152, 20.613295	1.6 km	Pjesa pas magjistrales është e patrajtuar dhe kërkon pastrim dhe mirëmbajtje, pasi që me daljen nga shtrati i këtij përroi vërshohen sipërfaqe të mëdha të tokave bujqësore, që

					kryesisht janë të mbjellura me perime. Gjatësia e këtij përroi është rreth 1.6 km.
4	Përroi në mes të fshatrave Krushë e Madhe dhe Celinë - nën rrugën magjistrale	42.312366, 20.607862	42.322424, 20.623096	1.55 km	Burimi i këtij lumi është nga fshati Hoçë e Madhe, i cili kalon nëpër vendbanimet Brestoc, Hoçë e Vogël, Nagaft dhe shkon në mes të fshatrave Krushë e Madhe dhe Celinë. Ky lum sjell sasi të mëdha ujërash, pasi akumulon edhe një pjesë të ujërave të qytetit të Rahovecit. Pjesa nën magjistralen Prizren-Gjakovë mbetet e patrajtuar dhe ka nevojë për pastrim dhe mirëmbajtje. Prania e shkurreve, inerteve si dhe zhavorit që ka mbuluar shtratin pengon rrjedhën normale të ujit.
5.	Përroi në fshatin Dejnë	42.433401, 20.523645	42.433584, 20.535832	1 km	Ky përrua kalon përmes fshatit Dejn, me gjatësi prej 1,000 m, dhe akumulon ujërat që vijnë nga fshatrat Senoc, Pastasel, Polluzhë dhe Dobidol. Pjesa e kanalit brenda fshatit Dejn është trajtuar dhe mirëmbajtur, ndërsa pjesa nga hekurudha deri te lumi Drini i Bardhë ka nevojë për pastrim dhe mirëmbajtje.
6.	Përroi në	42.448981,	42.454583,	4.27 km	Një nga përrenjtë më

	fshatin Çifllak - Dobidol	20.519049	20.564863		të gjatë në pjesën e Gradishit, i cili çdo vit shkakton dëme si pasojë e daljes së ujërave të rrëmbyeshëm nga shtrati, është përroi që ndan fshatrat Çifllak dhe Dobidol. Ky përrua mbledh ujërat nga kodrat e larta të fshatit Kaznik, që ndodhet në kufi me komunën e Malishevës, dhe derdhet në Drinin e Bardhë. Gjatësia e këtij përroi është 4.27 km.
7.	Përroi në mes fshatrave Kramovik - Çifllak	42.467298, 20.517978	42.468542, 20.528656	1.2 km	Gjatësia e këtij përroi është rreth 1.2 km, i cili ndan fshatrat Çifllak dhe Kramovik. Mbledh ujërat e pjesës kodrinore prej fshatrave Gur i Kuq dhe Kaznik, dhe shkarkohet në lumin Drini i Bardhë. Shtrati i lumit është i mbuluar me shkurre, inerte ndërtimi dhe zhavorr, të cilat pengojnë rrjedhën natyrale të ujit dhe po shkaktojnë përmytje gjatë reshjeve të mëdha.
8.	Përroi në mes fshatrave Bratotin dhe Vrajakë	42.412563, 20.539402	42.430536, 20.557757	3.47 km	Janë dy degë të përrenjëve që bashkohen dhe shkarkojnë ujërat në fshatin Ratkoc. Ky është njëri ndër përrenjtë më problematikë, i cili çdo vit del nga shtrati dhe krijon dëme si në

					ekonomitë familjare, ashtu edhe në të mbjellat e fermerëve të kësaj ane. Segmenti më i gjatë shkon në drejtim të fshatit Baboc, me gjatësi rreth 3.3 km, ndërsa segmenti tjetër shkon në drejtim të fshatit Vrajakë dhe është i gjatë 170 m.
9.	Përrenjet në fshatrat Nushpall, Pataqan i Ulët dhe Rimnik	42.388779, 20.604465	42.363963, 20.601582	14.99 km	Në pjesën perëndimore të qytetit të Rahovecit, në drejtim të fshatrave Pataqan i Ulët dhe Nushpall, rrjedhin tre përrenj të cilët janë mjaft problematikë, pasi të tre shkarkojnë ujërat në lumin Rimnik, në fshatin Fortesë. Pjesët që duhet të pastrohen dhe mirëmbahen janë kryesisht jashtë vendbanimit, pasi me buxhetin komunal janë trajtuar ato brenda tij.
10.	Përrenjet në fshatrat Opterushë, Zaqishtë dhe Retijë	42.369981, 20.716266	42.341797, 20.704365	5.71 km	Burimet e fshatrave Opterushë dhe Zaqishtë grumbullojnë ujërat e tyre dhe i shkarkojnë në fillim të fshatit Retijë. Të dy këta përrenj në hapësirat e banuara janë trajtuar nga niveli komunal dhe mirëmbahen rregullisht, ndërsa pjesët në tokat bujqësore kanë nevojë për pastrim dhe mirëmbajtje. Pas

					fshatit Retijë, ujërat shkarkohen në lumin Topllua në territorin e komunës së Prizrenit. • Zaqisht: 2.26 km • Opterushë: 2.1 km • Retijë: 1.35 km
--	--	--	--	--	--

*(Burimi: të dhëna të siguruara nga Komuna)




Figura 12. Përroi Kramovik - Çiflak, Përroi Çiflak - Dobidol, Përroi në Dejnë, Përroi i fshatit Ratkoc, Përroi Bratotin - Vrajakë në Komunën e Rahovecit kanë nevojë për pastrim.




Figura 13. Përroi Nashpall, Lumi Patacanit, Rimniku, Përroi Bellacerkë - Bellaja, Përroi Celinë nën Hekurdhë, Përroi Krushë e Madhe dhe Celinë, Përroi Retijë, Zaqishtë, Opterushë në Komunën e Rahovecit kanë nevojë për pastrim.



Foto 20. Përroi i fshatit Bellacërkë – Bellaja



Foto 21. Përroi në fshatin Celinë - nën Hekurudhë



Foto 22. Përroi në mes të fshatrave Krushë e Madhe dhe Celinë - nën rrugën magjistrale



Foto 23. Përroi në fshatin Çifllak – Dobidol



Foto 24. Përroi në mes fshatrave Kramovik – Çifllak



Foto 25. Përroi në mes fshatrave Bratotin dhe Vrajakë.



Foto 26. Foto nga vërshimet në Komunën e Rahovecit.

2.6. Komuna e Malishevës

Malishevën e përshkon lumi Mirusha, me toka të rrafshëta e pjellore në të dy brigjet e saj. Ndër sfidat kryesore që përballon kjo komunë në drejtim të gjendjes dhe menaxhimit të ujërave janë:

- Përmytjet e shpeshta nga lumi Mirusha;
- Ndotja e shtretërve të lumenjeve me mbeturina, dhe vegjetacion, të cilat jo vetëm që pengojnë rrjedhën e ujit, por janë edhe indikatorë të drejtpërdrejtë të ndotjes;
- Mungesa e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Bubël, ku derdhen 80% e ujërave të zeza të Komunës së Malishevës.

Përmytjet e lumit Mirusha kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme në ekonomi dhe në sipërfaqet bujqësore. Një nga masat kyçe për parandalimin e përmytjeve në komunën e Malishevës është pastrimi i shtratit të lumit, i cili aktualisht paraqet një burim serioz bllokimi për rrjedhën natyrore të ujit. Komuna thekson se i gjithë segmenti i lumit Mirusha, nga lokacioni Nguncat, Temeqin, Banjë, Turjakë dhe Bubël, ka nevojë për pastrim të plotë, me përjashtim të pjesës që kalon përmes qytetit, e cila pastrohet në mënyrë të rregullt nga shërbimet komunale, pjesa tjetër nuk është pastruar asnjëherë.

Tabela 6. Segmentet lumore për pastrim - Malishevë

Nr .	Segmenti i lumit	Koordinata e fillimit të segmentit	Koordinata e mbarimit të segmentit	Gjatësia e nevojshme për pastrim	Arsyeja, banorët/zona të prekura
1	Fshati Nguncat dhe Temeqin deri në Fshatin Banjë	Y=7488845.660 X=4701572.89 Nguncat Y=7485977.71 X=4699067.69 Temeqin	Y=7481815.61 X=4702694.19 Banjë	12km	Pastrimi i shkurrëve, pastrimi i bimësis ujore që tregon ndotjen eutrofikimit, pastrimi i mbeturinave të cilat gjatë reshjeve atmosferike shkakton përmbytje të mëdha.
2	Fshati Banjë deri te Ura e Qyteti Në Malishevë	Y=7481815.61 X=4702694.19	Y=7478830.81 X=4704729.79	5km	Pastrimi i shkurrëve, pastrimi i bimësis ujore që tregon ndotjen eutrofikimit, pastrimi i mbeturinave të cilat gjatë reshjeve atmosferike shkakton përmbytje të mëdha.
3	Ura e Qytetit deri në Fshatin Turjakë	Y=7478830.81 X=4704729.79	Y=7472321.56 X=4708450.19	10km	Pastrimi i shkurrëve, pastrimi i bimësis ujore që tregon ndotjen eutrofikimit, pastrimi i mbeturinave të cilat gjatë reshjeve atmosferike shkakton

					përmbytje të mëdha.
4	Fshati Turjakë deri në përfundim të Fshatit Bubël	Y=7472321.56 X=4708450.19	X=4709706.99 Y=7470712.46	4km	Pastrimi i shkurrëve, pastrimi i bimësisë ujore që tregon ndotjen eutrofikimit, pastrimi i mbeturinave të cilat gjatë reshjeve atmosferike shkakton përmbytje të mëdha.

*(Burimi: të dhëna të siguruara nga Komuna)




Figura 14. Lumi Mirusha që kalon nëpër fshatrat Ngucat, Temeqin, Banjë, Turjakë dhe Bubël.



Foto 27. Lumi Mirusha

Shtrati i lumit Mirusha, që shihen në fotografinë e mësipërme, paraqitet në gjendje të rënduar, i mbushur me vegjetacion, duke e bërë të pamundur qasjen, sidomos në pjesët jashtë zonës urbane.

2.7. Komuna Istog

Lumenjtë kryesorë të Istogut janë: Lumi i Istogut (Burimi), Lumi i Vrellës, Drini i Bardhë, Përroi i Keq, Shushica, Çausi, Gujavci, Bllagaca, etj. Ndër problemet kryesore me lumenjtë në këtë komunë janë:

- Ndotja e rrjedhave lumore nga mbeturinat dhe vegjetacioni;
- Rreziku nga vërshimet;
- Nevoja për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Denjë, e cila përfaqëson pikën më të ulët të sipërfaqes që mbledh ujërat e të gjithë qytetit përmes rrjetit të kolektorëve;

- nevoja për ndërtimin e tri digave mbrojtëse për lumenjtë Bollovani, Vrella dhe Lubozhda që shkaktuan vërshimet e fundit në pjesën e qytetit.

Duke u bazuar në të dhënat dhe gjendja në terren, lumenjtë që kanë shkaktuar përmbytje në komunën e Istogut janë kryesisht Gujavçi dhe Shushica, prandaj edhe kanë prioritetet për pastrim, për shkak të ndikimit të tyre dhe rrezikut potencial që sjellin.

Tabela 7. Segmentet lumore për pastrim – Istog

N r.	Segmenti i lumit	Koordinata e fillimit të segmentit	Koordinata e mbarimit të segmentit	Gjatësia e nevojshme për pastrim	Arsyeja, banorët/zona të prekura
1	Lumi Istogu	7457564.765 4738933.885	7460252.815 4736393.285	Rreth 20 km Bazuar në matje të Gjeoportalit	Parandalimi i përmbytjeve Zonat e prekura janë fshatrat në të cilat kalon lumi Istog: Muzhevina, Lluga, Tomoc, Zallq, Zabllaq, Drejë.
2	Drini i Bardhë	7446475.315 4732285.385	7460300.615 4726142.285	Rreth 17 km Bazuar në matje të Gjeoportalit	Parandalimi i përmbytjeve Zonat e prekura janë fshatrat në të cilat kalon lumi Drini i Bardhë: Baicë, Kashicë, Saradran
